



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

### GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2022:014507

Datë: 02.08.2022

Numri i dokumentit: 03289301

**PKR.nr.19/22**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Bekim Veliqi, në çështjen penale kundër të pandehurve Sh.K, A.I, A.F dhe E.R të gjitha nga Komuna e ... për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.142/20 e dt.20.01.2022, duke vendosur sipas kundërshtimeve të parashtruara nga te pandehurit, respektivisht i Sh.K, përmes mbrojtëset te tij av.Amir Rudaku, i pandehuri A.I permes mbrojtësit av.Mustafë Nuhiu, e pandehura A.F, përmes mbrojtësit av.Bajram Sherifi dhe kundërshtimi i parashtruar nga e pandehura E.R, kundërshtime te parashtruara pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, Gjykata në mbështetje të nenit 253 par.1 nën par.1.4 e lidhur me par.2 të KPP-së, me dt.02.08.2022, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

**I. HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.142/20 e dt.20.01.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve:

**1. SH.K**, nga i ati S., e ëma S., e gjinisë H., i lindur me dt.... në ... ku dhe jeton në rr.“...” p.n, me nr.personal ..., i pa martuar, ka të kryer fakultetin, inspektor i tregut në Komunën e ..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. A.I**, nga i ati H., e ëma A., e gjinisë S., i lindur me dt.... në ... ku dhe jeton në rr.“...” nr...., me nr.personal ..., i martuar, ka të kryer fakultetin teknik, inspektor i tregut në Komunën e ..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**3. A.F**, nga i ati J., e ëma R., e gjinisë M., e lindur me dt.... në ... ku dh jeton në Lagjen ... rr.... nr...., me nr.personal ..., e martuar, ka të kryer fakultetin ekonomik, e gjendjes së mirë ekonomike, inspektore e tregut në Komunën e ..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

**4. E.R**, nga i ati F., e ëma N., e gjinisë A., e lindur me dt.... në ... ku dhe jeton në rr.“...”, nr...., me nr.personal ..., e pa martuar, ka të kryer fakultetin e FSHMN-së, inspektore e tregut në Komunën e ..., e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

**II.** Hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës penale kundër të pandehurve Sh.K, A.I, A.F dhe E.R bëhet në mbështetje të nenit 253 par.1 nën par.1.4 të KPP-së, pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

#### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur Aktakuzën PP.nr.142/20 e dt.20.01.2022, kundër të pandehurve Sh.K, B.D, A.I, A.F dhe E.R të gjitha nga

Komuna e ... për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kryetari i trupit gjykues me dt.26.05.2022, ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, në seancën e shqyrtimit fillestar ka prezentuar Prokurori i Shtetit Naim Beka, të pandehurit Sh.K, A.I, A.F dhe E.R.

Në seancën e shqyrtimit fillestar nuk ka prezentuar i pandehuri B.D, i cili përmes parashtresës të dorëzuar nga familjarët e tij për shkak të gjendjes shëndetësore nuk ka mundur që të prezentojë në seancë, andaj Gjykata ashtu siç konstatohet në procesverbalin e seancës po ashtu në aktvendimin e dt.26.05.2022, ka marrë aktvendim dhe ka veçuar procedurën penale për të pandehurin B.D me arsyet e cekura si në aktvendim.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.26.05.2022, të pandehurit janë udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tyre konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të pandehurve është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, ku pas kësaj të pandehurit kanë deklaruar se e kuptojnë akuzën dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se të pandehurit e kanë kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia e deklarimit të tyre rreth pranimit apo mos pranimit të fajësisë për veprën penale me të cilën akuzohen.

Të pandehurit kanë deklaruar se nuk e ndiejnë vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohen.

Pas që të pandehurit kanë deklaruar se nuk e ndiejnë vetën fajtor, kryetari i trupit gjykues i ka njoftuar dhe udhëzuar të pandehurit mbi të drejtën e parashtrimit të kundërshtimit ndaj provave të cekura në aktakuzë sipas nenit 249 të KPP-së, në të drejtën e parashtrimit të kërkesës për hudhjen e akuzës nëse është e ndaluar ligjërisht dhe në kuptim të nenit 250 të KPP-së dhe të drejtën e paraqitjes së kërkesës për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale sipas ligjit, duke i përcaktuar afatet përkatëse.

Brenda afatit të përcaktuar të pandehurit Sh.K, A.I dhe A.F përmes mbrojtësve të tyre kanë paraqitur kundërshtimet e provave me kërkesën për hudhjen e aktakuzës kurse e pandehura E.R personalisht ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Prokurori i Shtetit nuk ka dhënë përgjigje në kundërshtimet e paraqitura nga të pandehurit dhe mbrojtësit.

I pandehuri Sh.K, përmes mbrojtësit av.Amir Rudaku në kundërshtimin e paraqitur ka theksuar se nuk ka asnjë provë të vetme me të cilën do të argumentohet qartë se i akuzuari Sh.K ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzua i është vënë në barrë, nuk kemi të bëjmë me formësimin e elementeve të veprës penale nga aktakuza e cila i vihet në barrë, nisur nga fakti se përshkrimi i dhënë faktik i veprës penale për të cilën akuzohen nuk kemi një prezantim të argumenteve me të cilën do të argumentohet mirë se i mbrojturi im ka vepruar në mënyrën e theksuar si në aktakuzë dhe se lidhur me këtë fare nuk është arritur që nxjerrja e një konkludimi të tillë edhe të faktohet, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me të dhëna apo përmbajtje të rreme, përkundrazi gjendja faktike është vërtetuar saktë nga inspektorët e autorizuar për këtë çështje siç është përshkruar në Procesverbalin 000080 nr.14 i dt.15.08.2022 dhe e cila gjendje faktike vërtetohet me provat e paraqitura si në fotografi dhe videosekuenca të propozuara në emër të mbrojtjes, nga këto prova shihet se lokali në fjalë i është përmbajtur Vendimit Nr.01/17 i dt.28.07.2020, i pandehuri në këtë rast Sh.K shihet në fakt shumë qartë dhe argumentohet me prova se kanë zbatuar detyrën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme si inspektor të autorizuar, përkundër që asnjëri nuk kanë qenë inspektor të fushës së gastronomisë, pasi që ishin inspektor të komunikacionit, inspektor të mbrojtjes së ambientit, inspektor të tregut etj., të njëjtit kanë bërë

inspektimin e lokalit dhe vërtetimin e gjendjes faktike konform Vendimit Nr.01/17 të dt.28.07.2022, nenit 18 par.18.1 dhe 18.2 për masat e parandalimit të pandemisë Covid 19, si dhe Manualit të Ministrisë së Shëndetësisë IKSHPK, për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid – 19, faqe 143 “udhëzime për gastronomi” qershor 2020, sipas Aktgjykimit KO61/20 i dt.05.05.2020, pasi që kufizimi i të drejtave dhe lirivi themelore mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit të Republikë së Kosovës, ndërsa në periudhën kur është nxjerr Vendimi Nr.01/17 i dt.28.07.2020, ishte i kundërligjshëm, konform aktgjykimeve të lartcekura pasi që Ligji nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, në territorin e Republikës së Kosovës, ka hy në fuqi me dt.25.08.2020, nga dëshmitë e tubuara asesi nuk mund të shërbejnë për ndërtimin e një platforme të aktceptueshme për të fuqizuar dyshimin se i akuzuari Sh.K të ketë realizuar me veprimet e tija atributet e veprës penale nga dispozitivi i aktakuzës ngase mungojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, i njëjti në asnjë mënyrë nuk është involvuar në kryerjen e veprimeve në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës dhe për këtë asesi nuk mund të identifikohet si person përgjegjës me asnjë provë të vetme dhe nuk mund të argumentohet se në veprimet e të pandehurit përmbajnë elemente të veprës penale për të cilën akuzohet i njëjti duke i propozuar Gjykatës që në bazë të nenit 250 par.1 nën par.1.1 dhe 1.4 të KPP-së, të hudhet aktakuza e Prokurorisë ngase në provat e bashkangjitura nuk japin mbështetje të mjaftueshme për ekzistimin e dyshimit të bazuar mirë ngase i mbrojturi im nuk ka marrë asnjë veprim të kundërligjshëm në drejtim të sajimit të figurës së veprës penale.

I pandehuri A.I, përmes mbrojtësit av.Mustafë Nuhiu, në kundërshtimin e paraqitur ka theksuar se aktakuza nuk është e bazuar dhe e ligjshme sepse nuk është e mbështetur në prova që dëshmojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, në dispozitivin e aktakuzës janë përcaktuar elementet e veprës penale të cilat në asnjë element të saj veprë nuk përmbajnë veprime inkriminuese të të akuzuarit A.I, e të cilat është dashur të shprehen me prova personale dhe materiale në raport me veprimet e të akuzuarit për tu konsideruar se është kryer vepra penale nga ana e të pandehurit, nga Procesverbali Nr.00080 i dt.15.08.2020, nuk është nënshkruar nga i pandehuri A.I ku shihet se në këtë procesverbal mungon nënshkrimi i tij, e këtë procesverbal e kanë nënshkruar personat e tjerë zyrtar, kurse i pandehuri A.I ka qenë në inspektim të lokaleve të tjera dhe fare nuk ka qenë prezent aty dhe nënshkruar i procesverbalit me rastin e përpilimit të tij, po ashtu nuk mund të vëretohet se i njëjti ka vërtetuar atë dokument pasi që nuk është nënshkruar nga i njëjti e po ashtu i njëjti nuk e ka përpiluar atë procesverbal për vet faktin se nuk e ka nënshkruar dhe nuk ka qenë prezent aty, provat e propozuara janë të papranueshme në pajtim me nenin 249 (1.2) lexuar së bashku me nenin 259 (1) të KPP-së, provat e theksuara në aktin akuzues nuk janë të një vlere provuese, ngase fillimisht nuk i referohen rrethanave apo fakteve që e ndërlidhin të pandehurin me ndonjë formë të veprimeve inkriminuese, raportet e zyrtarëve policor nuk përshkruajnë asnjë veprim të pandehurit lidhur me pretendimin e organit të akuzës për veprimet inkriminuese, zyrtarët policor për gjendjen faktike të lokalit e kanë bërë nga jashtë pa hyrë në lokal e megjithatë edhe nga këto foto vërtetohet se në lokalin e cekur gjendja ishte në harmoni me legjislacionin në fuqi, për më tepër këto foto dëshmojnë se procesverbali i hartuar nuk përmbante gjendje tjetër por ishte në respektim të masave kufizuese anti Covid-19, provat materiale të bashkangjitura përbëjnë prova shfajësuese, deklaramet e dëshmitarëve – zyrtarëve policor nuk mbështeten në provat materiale, e të cilat realisht kanë patur mundësinë që nëse do të kishte shkelje nga ana e të pandehurve gjatë kryerjes së detyrës zyrtare inspektuese, kanë mundur zyrtarët policor t’i evidentonin – fotografonin nga afër – brenda gjendjen e lokalit, nga gjendja faktike në teren nuk mund të paraqitet gjendje tjetër përveq asaj faktike e provuar edhe në foto nga vendi i ngjarjes, edhe dëshmitari A.I.2 nuk përshkruan gjendje tjetër përveq asaj që është e dukshme edhe përmes fotove nga vendi i ngjarjes, duke i propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 250 par.1 nën par.1.4 të KPP-së, ta hudh aktakuzën e prokurorisë në bazë të lartcekurave, ngase nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri A.I ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

E pandehura A.F, përmes mbrojtësit av.Bajram Sherifi, në kundërshtimin e paraqitur ka theksuar se që të ngritët aktakuza Prokuroria duhet të ketë prova të mjaftueshme të palëkundëshme që shkojnë në dëm të akuzuarit dhe që të njëjtat provojnë mjaftueshëm dyshimin e bazuar se personi i akuzuar ka kryer veprën penale që është objekt i shqyrtimit në po atë aktakuzë, në arsyetimin e elemeteve të veprës penale Prokuroria lidhur me të mbrojturën time bazohet në faktin se e njëjta ka përpiluar raport me të dhëna të rreme e të njëjtin dokument e nënshkruan, por ky arsyetim i Prokurorisë është i mangët nisur nga fakti se për t'u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, duhet të jetë i pranishëm qëllimi, ku kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm dhe me dëshirë të ndërmerr veprimet inkriminuese me ç'rast shkelen dispozitat penale, se e akuzuara nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dëshmohet edhe me provat që prokurorisë i janë ofruar nga ana e të akuzuarve e ku shihet qartë që në momentin kur është kryer inspektimi nga ana e Inspektorëve të komunës situata ka qenë krejt normale dhe në përputhje me vendimin e qeverisë, prokuroria nuk ka respektuar praimin se çdo fakt me pamundësi vërtetimi mirë do të shkojë në favor të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që në bazë të nenit 253 par.1 nën par.1.1 dhe 1.4 të KPP-së, të aprovohet si e bazuar kërkesa dhe të hudhet aktakuza e Prokurorisë dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurës.

E pandehura E.R në kundërshtimin e parashtuara ka theksuar se aktakuza nuk ka bazë të vlefshme juridike, nga leximi i aktit akuzues se prokurorisë në katër apo pesë rreshta është përmbledhja e disa fakteve dhe përshkrimi i disa provave të pa argumentuara në hollësi, pa një analizë të qartë dhe të mirëfilltë të rezultateve të hetimit, aktakuzës i mungonë elementi thelbësor e që është analiza se si ka ardhur përfundimi nga ana e prokurorisë, po ashtu dispozitivi i aktakuzës nuk është në harmoni me normën juridike dhe me kërkesat që duhet të përmbajë një dispozitiv, për veprimet procedurale policore lidhur me rastin mungonë një procesverbal mbi konstatimin e largësisë së bërjes së fotografive nga ana e zyrtarëve policor po ashtu koha e saktë dhe vendi kur janë bërë fotografitë, deklaratimet e zyrtarëve policor bazohen në hamendje se sa ka qenë largësia kur janë bërë fotografitë e po ashtu natën në ndikimin e dritës së reflektorëve largësia në foto nuk mund të pasqyrojë gjendjen reale të saktë, fotografia e bërë gjatë natës nga largësia bën që gjithçka të duke shumë më afër sesa është në realitet, nga provat në shkresat e lëndës rezulton një gjendje krejtësisht tjetër nga ajo që është prezentuar në dispozitiv të aktakuzës dhe në të gjitha pikat e saj, veprimet e mija nuk kanë të bëjnë me formësimin e elementeve të veprës penale nga aktakuza e cila më vihet në barrë nisur nga fakti se përshkrimi i dhënë faktik i veprës penale për të cilën akuzohem nuk kemi një prezentim të argumenteve me të cilën do të argumentohet se unë kam vepruar në kundërshtim me ligjin siç ka potencuar organi i akuzës, ngjarja e ditës kritike është zhvilluar në një mënyrë tjetër nga ajo që pretendohet me aktakuzë dhe se asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me të dhëna apo përmbajtje të rreme, përkundrazi gjendja faktike është vërtetuar saktë nga ne si inspektorë të autorizuar për këtë ka potencuar organi i akuzës, ngjarja e ditës kritike është zhvilluar në një mënyrë tjetër nga ajo që pretendohet me aktakuzë dhe se asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me të dhëna apo përmbajtje të rreme, përkundrazi gjendja faktike është vërtetuar saktë nga ne si inspektorë të autorizuar për këtë çështje, siç është përshkruar në Procesverbalin 000080 nr.14 i dt.15.08.2020, e cila gjendje faktike vërtetohet me provat e paraqitura si në fotografi dhe videosekuencat e propozuara në emër të mbrojtjes, distanca ka qenë e mjaftueshme sipas vendimit të Nr.01/17 i dt.28.07.2020 sipas nenit 18 par.18.1 dhe 18.2 dhe Manualit të Ministrisë së Shëndetësisë IKSHPK për mbrojtje nga përhapja e virusit covid-19 faqe 143 “udhëzime për gastronomi” qershor 2020, duke i propozuar gjykatës që në bazë të nenit 253 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurës për veprën penale si në aktakuzë.

Gjykata në vlerësimin e kundërshtimeve të parashtuar nga te pandehurit, – mbrojtësit, vlerësoj se kundërshtimet ndaj aktakuzës janë të bazuara në vlerësim të nenit 253 par.1 nën par.1.4 të KPP-së.

Gjykata vlerëson se Prokuroria ka bërë përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës mirëpo nuk i ka ndërlidhur elementet e veprës penale me prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen

Për të konsideruar se një veprë penale është kryer nga ndonjë person duhet që ai me veprimet e tij të konsumoj elementet e veprës penale e cila është e përcaktuar me ligj si e tillë, në mënyrë që i njëjti të ndiqet penalisht për atë veprë.

Gjykata thekson faktin se është obligim ligjor i Prokurorisë që me rastin e ngritjes së aktakuzës t'i përmbahet saktë dispozitave ligjore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, konkretisht Prokuroria me rastin e ngritjes së aktakuzës duhet që t'i përmbahet nenit 19 par.1 nën par.1.12 të KPP-së ku përcaktohet se *“nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”* po ashtu aktakuza të përmbajë kriteret kryesore të përcaktuara me nenin 241 të KPP-së, e që në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk janë përmbushur këto kriteret. Për më tepër Gjykata i referohet nenit 241 par.1 nën par.1.7 të KPP-së ku përcakton se *“Aktakzua përmbanë” ... “shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore”*, pra Prokuroria e ka për obligim ligjor që me rastin e ngritjes së aktakuzës të përcaktoj saktë arsyen për ngritjen e saj konkretisht të përcaktoj dispozitat ligjore konkrete të ligjit për të cilat pretendohet se janë shkelur nga ana e të pandehurit si dhe të ***ofroj prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale.***

Sipas Aktakuzës së parashtruar në dispozitivit të Aktakuzës në bazë të përshkrimit faktik ndërlidhur me veprimet subjektive të theksuara në dispozitivin e Aktakuzës, përjashtohet dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit me veprimet e tyre ka konsumuar elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, ***pasi që Prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë.***

Gjykata gjen se të pandehurit sipas Aktakuzës së Prokurorisë akuzohen për veprën penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës të pandehurit akuzohen se kanë ndërmarrë dy veprimet e kryerjes së veprës penale nga ky nen dhe atë përpilimin e dokumentit zyrtar me përmbajtje të rreme – procesverbalit me nr.000080 i dt.15.08.2020 dhe vërtetimin e dokumentit zyrtar me përmbajtje të rreme me anë të nënshkrimit - procesverbalit me nr.000080 i dt.15.08.2020.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm nga personat zyrtar e që në rastin konkret të pandehurit nga vlerësimi i Gjykatës kanë pasur cilësinë e personave zyrtar siç edhe ceket në Aktakuzë. Mirëpo Prokuroria në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit në rastin konkret me veprimet e tyre kanë konsumuar elementet – figurën e veprës penale për të cilën akuzohen.

Fillimisht Gjykata gjen se Prokuroria në pikën II tek pjesa e propozimeve në Aktakuzë ka propozuar që në cilësinë e provave të administrohen: aktvendimi mbi caktimin e kompetencës nr.227/2020 i dt.22.09.2020, raporti Fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-0862 i dt.15.08.2020, Raportin e oficerit Fadil Merovci te dt. 15.08.2020, Raportin e oficerit Granit Alidemaj te dt.15.08.2020, dëftesa mbi konfiskimin e pronës dt.18.08.2020, formular prone – dëshmie dt.15.08.2020, Raportin e oficerit Kujtim Ademi me numër të rastit 2020-CA-0862 te dt. 15.08.2020, Raporti i oficerit Izmi Basha i dt. 16.08.2020, procesverbali me nr. Serik 000080 nr.14 i dt. 15.08.2020, të bëhet vështrim në procesverbalet - blloku, foto- dokumentacioni, CD e rastit 2020-CA-0862, katër CD-e të ofruara nga të pandehurit B.D, Erlindë Rudaku, Sh.K, A.B.

Gjykata në këtë rast gjen se Prokuroria me rastin e ngritjes së Aktakuzës dhe vlerësimin se të pandehurit kanë ndërmarrë veprime inkriminuese për veprën penale për të cilën akuzohen, përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës nuk e mbështetë në ndonjë provë konkrete për të theksuar se pse Procesverbali me nr.000080 i dt.15.08.2020 është falsifikuar nga të pandehurit mirëpo vetëm thekson në përshkrim se “ ... edhe pse nga gjendja faktike që ka ekzistuar në lokalin – kafiterinë e përmendur ka pasur numër të madh të njerëzve dhe nuk është respektuar distanca sociale dhe nuk janë respektuar rregullat tjera të parapara nga Qeveria e Kosovës”,  **Kurse nuk e ka cekur madje as edhe një provë të vetme se ku bazohet konstatimi i tillë nga ana e Prokurorisë, pra Prokuroria faktin kryesor të çështjes e lë të pa mbështetur në prova konkrete për të përcaktuar se dokumenti në fjalë është falsifikuar nga ana e të pandehurve.**

Provat e ofruara nga ana e Prokurorisë të cekura si më lart në këtë Aktvendim nuk mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet duke u nisur edhe nga fakti se Prokuroria në rastin konkret ka propozuar që të administrohen si prova edhe Raportet e oficerëve policor të lartcekur, mirëpo Gjykata gjen se në rastin konkret këto Raporte policor nuk kanë ndonjë fuqi provuese për të vërtetuar ndonjë fakt konkret relevant të çështjes, për më tepër Gjykata thekson se Raportet e tilla policor tregojnë për ndërmarrjen e veprimeve për kryerjen e punëve zyrtare nga ana e zyrtarëve policor mirëpo nuk mund të kenë fuqinë provuese për të vërtetuar faktet e çështjes pasi që në këto raporte vetëm theksohen veprimet e ndërmarra nga ana e zyrtarëve policor ku për më tepër Gjykata gjen se në Raportet Policor të oficerëve Fadil Merovci, Granit Alidemja dhe Kujtim Ademi që në të tri këto raporte theksohet fakti i njëjtë se zyrtarët policor së bashku me inspektorët komunal – të pandehurit e lartcekura kanë shkuar për inspektim lidhur me zbatimin e masave anti Covid-19 dhe rreth orës 21:25 minuta kanë arritur në rr.“Muharrem Ibrahim”, te kafiteria “...”, ku aty kanë vërejtur që ka pasur  **një numër të konsiderueshëm të qytetarëve – klinetëve brenda kafiterisë, janë bërë fotografime nga zyrtarët policor nga jashtë lokalit kurse të pandehurit në cilësinë e inspektorëve komunal kanë hyrë brenda lokalit dhe kanë bërë inspektimin, ne kemi qëndruar jashtë, inspektorët komunal pasi na kanë informuar që e kanë përfunduar procedurën në këtë kafiteri ne kemi vazhduar me detyrat tjera policore.** Pra Gjykata nga këto raporte nuk gjen se mund të mbështetet dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, për më tepër këto raporte nuk mund të vërtetojnë madje as edhe një fakt relevant konkret lidhur me çështjen e elementeve – figurës së veprës penale apo faktin se të pandehurit kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese për të cilat akuzohen nga ana e Prokurorisë si në Aktakuzës.

Sa i përket Raportit Policor të oficerit Kujtim Ademi, Gjykata gjen se i njëjti në këtë raport ka përshkruar veprimet e ndërmarra nga ana e tij sipas detyrës zyrtare që i takon mirëpo në këtë raport po ashtu i njëjti ka bërë një konstatim dhe atë “... ku rreth orës 21:25 kemi shkuar në rr.“Muharrem Ibrahim” te kafiteria “...” dhe  **nga jashtë kemi vërejtur që ka pasur një numër i konsiderueshëm i klientëve brenda kafiterisë** ku gjitha tavolinat kanë qenë të mbushura me klient si dhe ka pasur edhe klient të cilët kanë qenë duke qëndruar në këmbë. Njësia e forenzikës  **ka bërë fotografimin e kësaj kafiterie nga jashtë dhe me pastaj ne kemi qëndruar jashtë dhe Inspektorët Komunal kanë hyrë në brendësi të lokalit dhe kanë bërë vëzhgimin e mbajtjes së distancës në mes klientëve,** ku një ashtu kanë kontaktuar me pronarin e kësaj kafiteri A.I.2 dhe rreth orës 21:33 Inspektorët Komunal pasi na kanë konfirmuar që e kanë përfunduar procedurën në këtë kafiteri ku të njëjtit kishin përpiluar procesverbalin me nr.14 i dt.15.08.2020 se në këtë kafiteri është duke u zbatuar distanca në mes të tavolinave si dhe mes personave, andaj ne raport zyrtari policor ka konstatuar se “**Procesverbali i përpiluar nga inspektorët komunal bie në kundërshtim me fotot e bëra nga zyrtari policor i krim teknikës ku me këtë dyshohet që Inspektorët komunal kanë kryer veprën penale ...**”. Gjykata po ashtu edhe nga ky raport nuk mund të gjejë se mbështetet dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet pikërisht bazuar në kundërthëniet e këtij raport.

Fillimisht Gjykata sqaron se Zyrtari Policor në këtë Raport ka theksuar se **“fotografimi i kafiterisë është bërë nga jashtë”** po ashtu ka theksuar se **“ne kemi qëndruar jashtë dhe Inspektorët Komunal kanë hyrë në brendësi të lokalit dhe kanë bërë vëzhgimin e mbajtjes së distancës në mes klientëve”**, pra Gjykata në këtë rast **nuk e sheh të qarte se si është e mundur që zyrtari policor nga jashtë lokalit madje as vet personalisht nuk i ka bërë fotografitë, as nuk ka hyrë në lokal të arrijë në një konstatim të tillë se lokali nuk i është përmbajtur rregullave të përcaktuara lidhur me pandeminë Covid-19 dhe madje të arrijë në një konstatim të atillë ku thekson se procesverbali bie në kundërshtim me fotografitë e bërë nga jashtë lokalit dhe për më tepër bënë edhe kualifikim në veprë penale duke u bazuar në konstatimet e tij pa asnjë fakt tjetër-pa bërë inspektimin nga brenda të lokalit, e ku për më tepër i njëjti vet ka theksuar se **“ne kemi qëndruar jashtë”**. Andaj Gjykata thekson se edhe nga ky Raport nuk mund të mbështetet dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.**

Sa i përketë Raportit Policor të oficerit Izmi Basha Gjykata gjen se në të njëjtin vetëm theksohen veprimet policor të cilat i kanë ndërmarrë me dt.16.08.2020 ku kanë shkuar në lokalin “...” për të marrë incizimet – DVR nga kamerat e sigurisë dhe se të njëjtat nuk kanë mundur që t’i sigurojnë, ndërsa sa i përketë faktit të vlerësimit të njëjtit, Gjykata gjen se jo vetëm që nuk mund të mbështetet dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në bazë të këtij raporti, por as nuk mund të themi se i njëjti ka të bëjë lidhur me ditën kritike pasi që asnjë fakt i vetëm nuk ceket në këtë raport lidhur me ditën kritike me dt.15.08.2020, kohë e theksuar nga ana e Prokurorisë në përshkrimin faktik në dispozitivin e aktakuzës.

Gjykata gjen se nga të gjitha Raportet Policore të lartcekura e të propozuara nga ana e Prokurorisë nuk mund të arrihet përfundimi se të njëjtat mbështesin mjaftueshëm dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale pasi që Gjykata në rastin konkret ka gjetur se Zyrtarët Policor të lartcekur me dt.15.08.2020 **vetëm kanë qenë të thirrur për të asistuar gjatë inspektimit të zyrtarëve komunal dhe të njëjtit nuk kanë qenë të thirrur për të bërë inspektime të lokaleve lidhur me zbatimin e masave anti Covid-19 madje fare nuk kanë hyrë brenda lokalit, zyrtarët komunal – inspektorët komunal në këtë rast të pandehurit kanë qenë personat konkret të thirrur sipas detyrës zyrtare për të bërë inspektimin lidhur me zbatimin e masave anti Covid-19, ku të njëjtit kanë hyrë brenda lokalit dhe kanë bërë inspektimin dhe nuk mund të arrihet përfundimi i tillë nga ana e Prokurorisë për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale duke u mbështetur në këto Raporte Policor pasi që të njëjtat nuk e mbështesin dyshimin e bazuar mirë bazuar në faktet e lartcekura nga Gjykata.**

Sa i përketë provave Aktvendimit për caktim kompetence Nr.227/2020 i dt.22.09.2020, Gjykata nuk mund të arrijë në ndonjë përfundim lidhur me atë se për çfarë arsye e ka propozuar Prokuroria vendimin e tillë që të administrohet si provë pasi që i njëjti është marrë nga ana e Prokurorisë së Apelit ku është caktuar Prokuroria Themelore Mitrovicë në kompetencë lëndore dhe territoriale për trajtimin e çështjes ndaj të pandehurve në këtë rast, andaj bazuar në këtë konstatim Gjykata e sheh të arsyeshme që fare mos të lëshohet në faktin se çka mund të vërtetojë kjo provë pasi që nuk do të ishte e logjikshme të bëhej një vlerësim i tillë i këtij vendim duke pasur parasysh faktin se për çfarë arsye është marrë ky vendim nga ana e Prokurorisë së Apelit.

Lidhur me Raportin Fillestar të Incidentit me numër të rastit 2020-CA-0862 i dt. 15.08.2020, Gjykata thekson se ky raport në asnjë mënyrë nuk mund të mbështes dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen duke pasur parasysh se Raporti i tillë i shërben zyrtarëve policor për të pasqyruar punën e tyre lidhur me kryerjen e detyrave zyrtare për informacionet që kanë marrë lidhur me ndonjë rast të incidentit, kurse sa i përket përmbajtjes së tij Raporti i tillë sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund mbështes në asnjë mënyrë dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale.

Sa i përket provave të tjera siç janë Procesverbali me nr.00080 nr.14 i dt.15.08.2020, fotodokumentacioni në shkresat e lëndës dhe Cd-të me video incizime, Gjykata gjen se provat e tillë nuk mbështes dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale përkundër kësaj të njëjtat vërtetojnë se të pandehurit kanë vepruar sipas kompetencave brenda detyrave zyrtare dhe kanë bërë përpilimin e procesverbalit në bazë të gjendjes faktike që e kanë hasur brenda lokalit, andaj mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se provat e tilla janë kundërthënëse në raport me Aktakuzën pasi që të njëjtit provojnë fakte të ndryshme nga ato që pretendohen në Aktakuzë, andaj si të tilla Gjykata vlerëson se këto prova nuk mund të mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Gjykata nga të gjitha të lartcekura arriti në përfundimin se Prokuroria në rastin konkret nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen bazuar në të lart cekurat, e kjo në kundërshtim me nenin 19 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 241 të KPP-së.

**Së pari, Prokuroria në këtë rast ka ofruar si prova Raportet e Oficerëve Policor Fadil Merovci, Grani Alidemaj, Kujtim Ademi dhe Izmi Basha,** e ku Gjykata ashtu edhe si në arsyetimin e lartcekura ka gjetur se në asnjë nga këto raporte nuk mund të arrihet përfundimi se mbështetet dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen pikërisht bazuar në faktin se oficerët policor ditën kritike ***nuk kanë qenë të thirrur për të bërë vlerësimin e zbatimit të masave anti Covid-19 mirëpo të njëjtit kanë qenë të thirrur vetëm në asistim të inspektorëve komunal të cilat kanë qenë në inspektim të lokaleve lidhur me zbatimin e masave anti Covid-19, zyrtarët policor në rastin konkret që të gjithë i kanë theksuar dy fakte kryesore dhe atë se të njëjtit kanë qëndruar jashtë lokalit ku është bërë inspektimi po ashtu kanë theksuar se inspektorët komunal në këtë rast të pandehurit kanë hyrë brenda dhe kanë bërë inspektimin e lokalit,*** andaj bazuar në këto rrethana Gjykata gjen se nuk mund të merret për bazë asnjë raport policor në mënyrë siç pretendon Prokuroria në rastin konkret për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen pasi që në mënyra e tillë e veprimit sipas vlerësimit të Gjykatës do të krijonte një pasiguri juridike në raport me atë se zyrtarët jo kompetent të bëjnë vlerësime jashtë kompetencave të tyre pa asnjë bazë, të arrijnë në përfundime të tilla se është kryer veprën penale ndërsa vlerësimi i zyrtarëve kompetent të merret si jo i drejtë pa kurfar baze,

**Së dyti, Prokuroria përshkrimin faktik në dispozitivin e aktakuzës e ka lënë të pambështetur në provat konkrete lidhur me faktin kryesor të çështjes** ku edhe më lart në këtë Aktvendim, Gjykata ka theksuar se Prokuroria në përshkrim vetëm ka theksuar se “ ... ku edhe të njëjtin dokument e nënshkruajnë edhe pse nga gjendja faktike që ka ekzistuar në lokalit – kafiterinë e përmendur ka pasur numër të madh të njerëzve dhe nuk është respektuar distanca sociale dhe nuk janë respektuar rregullat tjera të parapara nga Qeveria e Kosovës”, pra në rastin konkret Gjykata nuk ka mundur që të gjejë se në bazë të cilave provave konkrete ka arritur në një përfundim të tillë duke pasur parasysh që asnjë nga provat e propozuara nga ana e Prokurorisë nuk e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, për më tepër provat siç janë Fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës, Cd-të me video incizime dhe vet Procesverbali nr.14 000080 i dt.15.08.2020, janë në kundërshtim direkte me përshkrimin e tillë si në dispozitivin e aktakuzës pasi që pikërisht këto prova sipas vlerësimit të Gjykatës e vërtetojnë të kundërtën e asaj që pretendon Prokuroria.

**Së treti, Gjykata gjenë** se në rastin konkret Aktakuza e ngritur është në kundërshtim me nenin 19 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 241 të KPP-së dhe se mungojnë prova konkrete bindëse që do të mund të mbështesin dyshimin e bazuar se të pandehurit ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohen.



Gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktvendimi duke pasur mbështetje në nenin 253 par.1 nën par.1.4 të KPP-së ku përcakton se *“Për çdo kërkesë për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:” ... “nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë”*.

Nga ajo që u konstatua si më lart në mbështetje të nenit 253 par.1 nën par.1.4 të KPP-së, Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.19/22 dt.02.08.2022**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
**Bekim Veliqi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.